



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshtatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e pyetjes, komisioni i vlerësimit është i detyruar të këshillohet me drejtuesin teknik dhe me specialistët e AVA, për të bërë vlerësimin përfundimtar.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* është specifikuar me kujdes. Vlerësimi i saj do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Gjergj Elez Alija**

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë**

a) përgjigjur

b) dredhuar

- **2 pikë**, nëse nxënësi i shkruan saktë të dy fjalët në përputhje me formën e përdorimit në fragment..
- **1 pikë**, nëse jep saktë vetëm një të njënjë fjalë.
- **0 pikë**, nëse nuk jep asnjë të gabuar ose jep përgjigje të gabuar.

Pyetja 9 **2 pikë**

a) kuptim i kundërt me atë që ka shprehja në fragment.

b) ironia.

- **2 pikë**, nëse nxënësi jep kuptimin dhe figurën.
- **1 pikë**, nëse nxënësi jep vetëm njërin.
- **0 pikë**, nëse jep përgjigje të gabuar ose nuk jep përgjigje fare.

Pyetja 10 **3 pikë**a) **hiperbolat:**

- qe nandë vjet qi kam marrë rrugn' e vorrit,....
- dymbdhetë pash n'ledinë u ngul topuzi,
- dymbdhetë pash përpjetë si re u çue pluhni.
- të tanë lumën gjaku e ka tërzue,
- për tri vjet krejt vendin e ka qelbun.
- A'trandë fusha kur a'rrxue Balози.

b) përdoren për të bërë përshtypje të madhe, për të vënë në dukje më mirë figurën dhe veprimet e heroit, tregon madhështinë e tyre në përmasa të çuditshme.

- **3 pikë**, kur nxënësi gjen dy hiperbola dhe shpjegon funksionin e tyre.
- **2 pikë**, kur nxënësi gjen vetëm dy hiperbolat ose një hiperbolë dhe shpjegon funksionin e saj.
- **1 pikë**, kur gjen vetëm një të hiperbolë.
- **0 pikë**, kur jep përgjigje të gabuara ose asnjë përgjigje.

Pyetja 11 **3 pikë**

a) konke çue/ po thue/ m'ke dredhue/ m'ke kallzue/ kanë lanë/ia dhanë, ka shinue/ka fjurue/ka ardhë/ka dredhë, ka xjerrun/ka damun/ ka ngrehun/ ka mbytun/ ka qelbun/ .

b) mejdanin/çobanin/, topuzi/pluhni, mejdanit/vorrit/ dita/Alija/ .

c) krijojnë muzikalitet.

- **3 pikë**, nëse nxënësi gjen nga një rimë për secilin rast dhe jep efektin që ato shkaktojnë.
- **2 pikë**, nëse gjen një rimë dhe jep efektin, ose gjen vetëm dy rimat.
- **1 pikë**, nëse nxënësi gjen vetëm një rimë.
- **0 pikë**, nëse përgjigja nuk përshtatet me kërkesat ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 12 **3 pikë**

Pikat kyç të brendisë në këtë fragment, sipas kronologjisë së ngjarjes janë:

- nisja e ditës së re.
- dalja e trimave në fushë
- ndeshja me fjalë
- ndeshja me armë
- vdekja e Balozit
- triumfi i Gjergjit
-

Nxënësi do të rendisë në mënyrën e tij të të shprehurit tre nga momentet e mësipërme.

- **3 pikë**, kur jep me rend kronologjik tre nga momentet.
- **2 pikë**, kur jep dy nga momentet, ose jep tre.
- **1 pikë**, kur jep vetëm njërin.
- **0 pikë**, për përgjigje që nuk kanë lidhje me përgjigjet më lart ose nuk shkruan fare,

Pyetja 13 **4 pikë**

- a) Gjergji ndodhet përballë Balozit, sepse ai i ka kërkuar motrën. Gjergji kërkon më parë të ndeshet me të.
- b) Kodi është kanuni i të parëve.
- c) Vargu: *se ne t'parit nji kanu na kanë lanë.*
- d) Ky varg shpreh thelbin e zakoneve dhe traditave tona, mbi vlerat, konceptin e nderit dhe familjen. (përgjigja e nxënësit, e cila është shprehur në mënyrë individuale, duhet të përmbajë këtë ide).

- **4 pikë**, kur nxënësi jep të gjitha përgjigjet e mësipërme.
- **3 pikë**, kur nxënësi jep 3 nga përgjigjet më lart.
- **2 pikë**, kur nxënësi jep dy nga përgjigjet më lart.
- **1 pikë**, kur nxënësi jep vetëm njërin nga përgjigjet më lart.
- **0 pikë**, për përgjigje të gabuar, ose kur nuk shkruan fare.

Pjesa II**Heminguej****Lamtumirë armë**

Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë

Pyetja 20 **3 pikë**

- a) I lodhur, i dërrmuar, i trishtuar.
- b) sepse e urrente luftën dhe nuk po e shijonte pranverën.
- c) e ndjej veten si të dërrmuar, por urrej luftën, jam i lodhur, jeni i trishtuar, nga shkak i pranverës.
- **3 pikë**, nëse nxënësi jep 1 tregues të gjendjes së priftit, arsyeën pse ndjehej i tillë dhe detajin.
 - **2 pikë**, nëse nxënësi jep dy nga përgjigjet më lart.
 - **1 pikë**, kur jep vetëm një përgjigje.
 - **0 pikë**, kur jep përgjigje të gabuar ose nuk shkruan asgjë.

Pyetja 21 **2 pikë**

- a) soditës, në fragmentin e fundit, përshkrimi i vendeve të bukura..
- b) pjesëmarrës, kur bisedon me priftin, dialogjet me priftin.
- **2 pikë**, kur jep dy shembujt.
 - **1 pikë**, kur jep një shembull.
 - **0 pikë**, kur nuk jep asnjërin ose i jep gabim.

Pyetja 22 **3 pikë**

- a) Abrucet, Kaprakota, Gran sasso d’italia, Akuila.
- b) Dëshira për jetë, largimi nga situata dhe biseda mbi luftën, ëndrra për një tjetër jetë, dëshira për t’i thënë lamtumirë luftës dhe plagosjes për të shijuar bukuritë që të fal jeta, njerëzit, natyra.etj. (pranohet formulimi personal i nxënësit që jep këtë ide).
- c) Kishte trofta në lumë, tregohej i gëzuar, tingulli i fyellit, pranvera e abruceve, si pranvera më e bukur e Italisë, mishi i shijshëm i zogjve, djemtë me pseudonimin “ Don”. (pranohen edhe detaje të tjera nga fragmenti që lidhen me arsyen e dhënë).
- **3 pikë**, kur jep vendet me arsyen dhe të paktën një ilustrim.
 - **2 pikë**, kur jep dy nga treguesit më lart.
 - **1 pikë**, kur jep vetëm një tregues.
 - **0 pikë**, nëse nxënësi nuk jep asnjërin nga përgjigjet, ose jep përgjigje të gabuar.

Pyetja 23 **3 pikë**

a) ligjërimi bisedor

b + c) tiparet që mund të dalin janë këto:

- dialogu, (pyetje përgjigje), tematika e bisedës, fjalët e komunikimit të përditshëm, thjeshtësia, natyra e sintaksës, etj. (pranohet edhe ndonjë tipar tjetër i gjetur nga nxënësi që lidhet me ligjërimin bisedor).

***Shënim:** shembujt merren nga fragmenti për rastin e zgjedhur. P.sh nëse zgjidhet dialogu si tipar, themi që gjithë pjesa e parë e fragmentit e demonstroi këtë. Nëse zgjidhet tematika, kjo del te tema e luftës.*

- **3 pikë**, nëse nxënësi jep llojin e ligjërimin, dy tipare me shembujt përkatës..
- **2 pikë**, nëse jep llojin e ligjërimin, tiparin me shembullin përkatës, ose nëse jep dy tiparet me shembujt përkatës.
- **1 pikë**, nëse jep vetëm llojin e ligjërimin, ose vetëm njërin nga tiparet me shembull.
- **0 pikë**, për përgjigje të gabuar, ose mungesë përgjigjeje.

Pyetja 24 **1 pikë**

Shenja e pikësimit është (-).

- **1 pikë**, nëse e gjen shenjën.
- **0 pikë**, për përgjigje të gabuar dhe mungesë përgjigjeje.

Pyetja 25 **8 pikë**

25a Shtjellimi i idesë 2 pikë. Duhet të kihet parasysh:

- Fokusimi në temë, përshtatja me qëllimin e temës.
 - Të flasë mbi një dëshirë të tijën.
 - Të tregojë kur ka lindur dhe si ka lindur kjo dëshirë.
 - Të përshkruajë arsyet pse e pëlqen atë.
 - Të argumentojë mundësitë e realizimit ose mosrealizimit të saj.
 - Të thotë nëse ky dëshirë ka ndikuar ose mund të ndikojë në jetën e tij.
- **2 pikë**, kur ka treguesit e mësipërm.
 - **1 pikë**, kur trajton temën përkatëse, por nuk jep argumente të qarta në lidhje me të
 - **0 pikë**, kur nuk përshkruan asgjë, ose kur ajo që shkruan nuk ka kuptim.

25b Organizimi dhe struktura 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Pjesët përbërëse (hyrje, zhvillim, mbyllje).
 - Kronologjia (rend të mendimit dhe ideve, të shembujve që jep).
 - Logjika (të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë).
 - Kalimet e kuptimshme (nga dëshira te njeriu dhe efektet e tij), etj.
- **2 pikë**, kur nxënësi i plotëson standardet e mësipërme.
 - **1 pikë**, kur respekton vetëm strukturën formale, por nuk demonstroi cilësi në ndërthurjen e saj me kuptimin.
 - **0 pikë**, kur struktura nuk të jep asnjë kuptim.

25c Stili dhe origjinaliteti 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Shprehjet origjinale (figuracioni, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
 - Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues, (me rrjedhshmëri, të ketë efekt)
 - I qartë.
 - Jo imitues (të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij).
- **2 pikë**, kur ka treguesit e mësipërm.
 - **1 pikë**, kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.
 - **0 pikë**, kur nuk thotë asgjë, ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

25d Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë Duhet të kihen parasysh:

- Trajta e duhur e fjalëve.
 - Fjali të sakta.
 - Shenjat e pikësimit.
 - Shkronja e madhe.
- **2 pikë**, kur nxënësi ka bërë një përshkrim brenda normave të mësipërme
 - **1 pikë**, kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar.
 - **0 pikë**, kur gabimet e shumta deformojnë ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.